

QERSHOR 2026

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2026

© Ministria e Financave, 2026

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

E-mail: Rei.Qerimi@financa.gov.al, Elkejdo.Pacani@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
--------------------------	----------

ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
-----------------------------	----------

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10

SEKTORI FISKAL	11
-----------------------	-----------

1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12

ANEKSI STATISTIKOR	13
---------------------------	-----------

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në qershor 2026, arriti në 102.77. Norma vjetore e inflacionit për muajin qershor 2026 ishte 3.2 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin qershor 2026 ishte 82.28 lekë për dollarë dhe 94.79 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit qershor 2026 shënuan normën 1.59 dhe 2.23 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit qershor 2026 shënuan normën 5.82 dhe 6.03 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 2,048,794 milionë lekë në muajin qershor 2026, duke shënuar një rritje prej rreth 11.9 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë 2026 rezultoi pozitiv, me një rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 20 milionë euro;
- Situata buxhetore për muajin qershor 2026 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 52.8 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 23.8 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin qershor 2026 arritën në rreth 410.9 miliardë lekë, ose afërsisht 12.2 përqind më shumë se muaji qershor 2025 dhe 5.0 përqind më shumë krahasuar me planin e periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 358.1 miliardë lekë, ose rreth 7.5 përqind më shumë se muaji qershor 2025 dhe 97.5 përqind realizim kundrejt planit të periudhës.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Inflacioni vjetor për muajin qershor 2026 shënoi normën 3.2%, duke reflektuar rritje në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 2.4%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin qershor 2026, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rënie me 0.1%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-qershor 2026 është 2.7%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Ushqime dhe pije joalkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +3.0%, duke kontribuar me +1.02 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

“Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.96 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

“Transporti” me rritje vjetore të çmimit prej +3.2%, duke kontribuar me +0.21 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.



“Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me rritje vjetore +2.7%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

“Restorante dhe shërbime akomodimi” me rritje vjetore të çmimit prej +3.3%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +3.5%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

“Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +3.2%, duke kontribuar me +0.14 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.2%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2025	2.0	1.9	2.1	2.3	2.2	2.4	2.5	2.3	2.4	2.3	2.1	2.3
2026	2.3	2.5	2.6	2.8	3.0	3.2						

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin qershor 2026 arriti në 94.79 lekë/euro, duke u ulur me 0.72 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit qershor, një euro u këmbye me 94.14 lekë. Gjatë muajit qershor 2026 kundrejt dhjetor 2025, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj euros në 0.7 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin qershor 2026 arriti në 82.28 lekë/dollarë, duke shënuar rritje me 0.63 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 82.64 lekë/dollarë. Gjatë muajit qershor 2026 kundrejt dhjetor 2025, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj dollarit në 0.4 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.87 dollarë/euro për muajin qershor 2026.


Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 3.34 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 3.32 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit vijuan gjatë muajit qershor 2026, por ato paraqiten më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Presionet e brendshme inflacioniste mbeten kontribuesi kryesor në inflacion, si pasojë e zgjerimit të aktivitetit ekonomik, kushteve të shtrënguara në tregun e punës, si dhe rritjes së çmimit të qirave, karburanteve dhe shërbimeve të transportit. Nga ana tjetër, presionet inflacioniste nga jashtë, ndonëse mbeten ende të dobëta, janë forcuar duke reflektuar rritjen e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e zhvillimeve në Lindjen e Mesme. Në përgjithësi, tregu valutë është karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit qershor 2026, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.59 dhe 2.23 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve janë ulur me 0.01 pikë përqindje, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë ulur me 0.35 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rritje me 0.01 pikë përqindje dhe janë ulur me 0.06 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin qershor 2026, kanë shënuar normën 2.62 përqind, nga 2.75 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore është rritur me 0.06 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë ndërsa krahasuar me një vit më parë, ka shënuar rënie me 0.13 pikë përqindje.

Gjatë muajit qershor 2026, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 5.82 dhe 6.03 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u ulën me 0.03 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u ulën me 0.22 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rënie me 0.09 pikë përqindje për Individët dhe rënie me 0.51 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.





4. Bilanci i Pagesave T1-2026

Në tremujorin e parë të vitit 2026, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, me një rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 20 milionë euro, nga 576 milionë euro që ishte në tremujorin e parë 2025.

Llogaria korrente u mbyll me balancë negative prej rreth 228.3 milionë euro, duke u ngushtuar në terma vjetorë me rreth 88 milionë euro. Zgjerimi i suficitit në shërbime, përmirësimi i balancës së të ardhurave parësore dhe rritja e transfertave korrente neto mbeten faktorët përcaktues të këtij rezultati. Llogaria financiare dhe kapitale rezultoi në fluks neto hyrës prej rreth 201 milionë euro, krahasuar me 893.1 milionë euro në tremujorin e parë 2025.


Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 404 milionë euro ose +11.8 përqind më shumë, krahasuar me +361 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2025. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 274 milionë euro, ose +9.4 përqind, krahasuar me +251 milionë euro në tremujorin e parë 2025.

Gjatë tremujorit të parë 2026, mjetet e rezervës shënuan një rritje prej rreth 20 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të parë 2026, shënon vlerën prej 7,419 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.6 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit qershor 2026, sistemi bankar ka shënuar vlerën prej rreth 1,169,421 milionë lekë të mjeteve valutore neto (M.V.N), duke u rritur me rreth 126,538 milionë lekë krahasuar me muajin qershor 2025. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 83,254 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 3,640 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 13,892 milionë lekë në bankat e tjera depozituese.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 2,048,794 milionë lekë në muajin qershor 2026, duke shënuar një rritje prej 217,736 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 11.9 përqind.



Në muajin qershor, sistemi bankar rezultoi me rritje mujore prej 20,631 milionë lekë, ose 1.0 përqind më shumë krahasuar me muajin maj 2026.


6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin qershor 2026 arriti në rreth 992,771 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 99,737 milionë lekë, ose rritje me rreth 11.2 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (60.2%) dhe monedhave të huaja (39.8%).

Gjatë muajit qershor 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 54.4 përqind ose 539,847 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin rreth 42 përqind ose rreth 417,254 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 1.6 dhe 2.0 përqind, ose 15,476 dhe 20,186 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin qershor 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 75.7 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 21.5 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.2 dhe 0.7 përqind secili.


Fig. 9



Rritja e stokut total të kredive Qershor'26

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig. 10




Përbërja e kredive Qershor'26


Burimi: Banka e Shqipërisë

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 505,722 milionë lekë në fund të muajit qershor 2026. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në qershor 2026 ka shënuar një rritje mujore prej 0.33 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.55 pikë përqindje, duke arritur nivelin 24.7 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.58 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.96 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 32.8 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin qershor 2026, kanë shënuar rritje vjetore prej rreth 43,507 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 73.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit qershor 2026, shënuan rritje vjetore prej 110,408 milionë lekë. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 73.8 përqind të depozitave në lekë.




Në muajin qershor 2026, depozitat totale përbëjnë 75.3 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 0.55 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit qershor 2026, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 73.8 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 17.8 përqind dhe nga “Korporata jofinanciare publike” me 5.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.3 përqind dhe rreth 23.1 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 73.6 përqind të totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,135,166 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (316,111 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (51,616 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (31,395 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 8,784 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit qershor 2026, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,543,072 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rritje me rreth 8,782 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 153,916 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin qershor 2026 janë mbledhur rreth 410.9 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej rreth 358.1 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 321.1 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 137.1 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 260.1 miliardë lekë (1.7% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 34.8 miliardë lekë (ose 68.2% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 99.6 miliardë lekë (ose 2.9% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 13 miliardë lekë (ose 91.8% realizim kundrejt planit të periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 321.1 miliardë lekë, 65.3 miliardë lekë (20.4% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 31.3 miliardë lekë (9.8% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 30.5 miliardë lekë (9.5% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.2 miliardë lekë (0.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 137.1 miliardë lekë (42.7%) për shpenzime për fonde speciale, 42.2 miliardë lekë (13.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 13.4 miliardë lekë (4.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

Shpenzimet kapitale për muajin qershor 2026 janë realizuar në masën 37 miliardë lekë.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin qershor 2026 ishin rreth 410.9 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 394.5 miliardë lekë, të ardhurat jotatimore në rreth 13 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Qershor 2026 (mln Lekë)

Emërtimi	Qershor'26	Qershor'25	Qershor'26/ Qershor'25 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	120,698	109,091	10.6
Tatimi mbi Fitimin	31,065	33,237	-6.5
Akcizat	33,550	32,083	4.6
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	47,572	40,810	16.6
Taksa Nacionale dhe të tjera	22,240	22,664	-1.9
Taksa Doganore	4,974	4,511	10.3

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Korrik 2026

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për muajin qershor 2026 shënoi një suficit prej rreth 52.8 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 23.8 miliardë lekë. Suficiti prej 52.8 miliardë lekë dhe financimi i huaj prej 1 miliardë lekë, u përdorën për financimin e deficitit të brendshëm prej 53.8 miliardë lekë.

Për muajin qershor 2026, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 410.9 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 358.1 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin qershor 2026, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 394.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 321.1 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 137.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	
Janar	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	3.7	7.2	3.4	2.0	2.3	January
Shkurt	1.3	1.1	0.3	0.3	0.5	1.3	1.1	0.4	0.4	0.5	3.9	7.1	2.6	1.9	2.5	February
Mars	2.4	0.7	0.4	0.6	0.7	1.7	1.0	0.4	0.4	0.5	5.7	5.3	2.3	2.1	2.6	March
Prill	0.7	0.0	-0.2	0.1	0.3	1.4	0.9	0.3	0.4	0.5	6.2	4.6	2.1	2.3	2.8	April
Maj	-0.5	-0.3	-0.2	-0.3	-0.04	1.0	0.7	0.2	0.2	0.4	6.7	4.7	2.2	2.2	3.0	May
Qershor	-0.1	-0.3	-0.4	-0.2	-0.1	0.9	0.6	0.1	0.2	0.3	7.4	4.5	2.1	2.4	3.2	June
Korrik	0.2	-0.1	-0.2	-0.1		0.8	0.5	0.0	0.1		7.5	4.2	2.1	2.5		July
Gusht	0.8	0.6	0.5	0.3		0.8	0.5	0.1	0.1		8.0	4.0	2.0	2.3		August
Shtator	0.6	0.7	0.6	0.7		0.7	0.4	0.1	0.2		8.1	4.1	1.9	2.4		September
Tetor	0.4	0.1	0.1	0.1		0.7	0.4	0.1	0.2		8.3	3.8	1.9	2.3		October
Nëntor	-0.3	-0.2	0.0	-0.2		0.6	0.3	0.1	0.2		7.9	3.9	2.0	2.1		November
Dhjetor	0.4	0.5	0.6	0.7		0.6	0.3	0.2	0.2		7.4	4.0	2.1	2.3		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Monedha	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	2026 Prill April	2026 Maj May	2026 Qershor June	Currency
Mesatarja e periudhës											Average of period
USD	113.04	100.65	93.09	86.80	82.27	81.53	83.06	81.81	81.76	82.28	USD
EURO	118.98	108.80	100.71	97.85	96.56	96.44	96.04	95.68	95.48	94.79	EURO
Fundi i periudhës											In the end of period
USD	107.05	93.94	94.26	82.46	81.13	81.64	83.76	81.76	82.04	82.64	USD
EURO	114.23	103.88	98.15	96.77	96.70	96.36	96.03	95.53	95.45	94.14	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	2026 Prill April	2026 Maj May	2026 Qershor June	In percent
Norma e interesit të depozitave për individët							Interest rates on households deposits
Deri në 1 vit	1.29	1.34	1.28	1.28	1.40	1.25	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.59	1.46	1.37	1.51	1.57	1.52	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.44	2.39	2.30	2.32	2.27	2.46	Over 2 years
Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare							Interest rates on nonfinancial corporations deposits
Deri në 1 vit	2.11	2.19	2.44	2.39	2.55	2.15	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.70	2.37	3.13	3.50	2.72	2.43	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.75	3.10	2.95	3.00	2.81	3.30	Over 2 years
Normat e interesit të kredive për individët							Interest rates on household loans
Kredi për banesa	3.91	4.07	3.86	3.79	3.77	3.77	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.63	8.32	8.24	9.01	8.56	8.49	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	13.10	12.63	9.12	9.64	10.29	9.12	Credit for other purposes
Normat e interesit të kredive për korporatat jofinanciare							Interest rates on nonfinancial corporations loans
Kredi deri në 140 milionë lekë	6.79	7.27	6.65	7.12	6.32	6.36	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	5.10	7.84	5.93	6.46	6.14	5.71	Loans over an amount of 140 millions of lek
Norma e letrave me vlerë							Securities rates
Bono thesari 1/							Treasury bills 1/
3-M	2.46	-	-	2.44	-	2.40	3-M
6-M	-	-	2.39	-	2.40	-	6-M
12-M	2.44	2.43	2.47	2.51	2.56	2.62	12-M

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2026

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

Nr.	E M E R T I M I	January Janar	February Shkurt	March Mars	April Prill	May Maj	June Qershor	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	69,989	130,390	205,745	275,917	341,002	410,877	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	158	332	2,086	2,315	2,938	3,306	Grants
II.	Të ardhura tatimore	67,671	125,403	197,123	264,989	327,378	394,549	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	43,775	80,865	131,442	172,722	215,511	260,100	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,475	39,987	60,506	79,070	99,999	120,698	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	3,442	7,399	19,605	23,574	26,647	31,065	Profit Tax
3	Akcizat	5,208	10,027	14,945	20,403	26,264	33,550	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,621	14,133	22,933	31,715	40,218	47,572	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,414	7,971	11,223	14,853	18,364	22,240	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	614	1,348	2,230	3,107	4,019	4,974	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	6,861	12,165	17,194	25,186	28,547	34,806	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	541	957	1,812	3,935	4,660	5,924	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	3	4	4	7	13	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	6,319	11,206	15,378	21,247	23,880	28,869	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	17,035	32,373	48,487	67,082	83,321	99,643	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	14,653	27,988	41,992	58,007	72,081	86,245	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,316	4,255	6,277	8,760	10,840	12,905	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	66	131	218	314	400	492	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	2,160	4,655	6,537	8,613	10,686	13,023	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	-	0	-	0	-	-	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,082	2,690	3,640	4,603	5,581	6,697	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	354	619	858	1,162	1,480	1,888	Utility fees
4	Të tjera	724	1,346	2,038	2,820	3,596	4,407	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	48,282	100,680	156,680	221,936	287,306	358,080	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	47,555	98,926	150,807	206,775	261,002	321,056	Current Expenditures
I.1	Personell	10,287	20,705	31,914	43,164	54,300	65,344	Personnel expenditures
1	Paga	8,825	17,771	27,407	37,038	46,595	56,063	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,451	2,909	4,455	6,013	7,555	9,087	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	12	25	52	113	150	194	Higher education from its own income
I.2	Interesat	9,274	16,430	20,130	23,023	24,910	31,302	Interest
1	Të Brendshme	8,365	12,291	14,924	17,154	18,089	18,489	Domestic
2	Të Huaja	909	4,139	5,207	5,869	6,822	12,813	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,304	6,739	11,080	17,764	24,954	30,535	Operational & Maintenance
I.4	Subvencionet	109	324	565	800	958	1,150	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	20,093	41,241	63,704	88,028	111,419	137,121	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	16,066	32,186	49,472	67,267	85,343	104,408	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	4,043	8,857	13,833	20,270	25,449	31,866	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	-	17	199	490	627	848	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	3,996	9,596	17,121	25,363	33,442	42,226	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,492	3,892	6,293	8,633	11,019	13,377	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	126	204	289	437	544	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,433	3,365	5,384	7,330	9,322	11,301	Economic Aid
3	Kompensim për ish të përndjekurit politike	0	200	405	515	660	832	Compensation for the political persecuted
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca							Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	728	1,754	5,873	15,162	26,303	37,024	Capital expenditures
1	Financimi i Brendshëm	-	6	2,852	10,696	19,992	28,338	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	-	2	129	250	361	365	From higher education system's own revenues
3	Financimi i Huaj	728	1,695	2,766	3,630	5,271	7,506	Foreign financed
IV	Fondi i rindërtimit	-	52	126	586	679	814	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	21,707	29,710	49,065	53,980	53,697	52,797	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-	21,707	-	49,065	-	52,797	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-	20,517	-	44,472	-	53,829	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	3	7	13	16	22	30	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-	13,428	-	35,760	-	18,317	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-	7,092	-	8,725	-	35,542	Others
V.3	i huaj	-	1,190	-	4,593	744	1,032	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	517	1,406	2,026	2,678	3,930	5,906	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	72	16	122	51	34	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-	1,813	-	6,983	-	15,553	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	-	349	349	7,740	10,388	10,645	Budgetary Support

Burmë : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja.

Tab - 5

Tabela e investimeve 2026

Table of investments 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Financim i brendshëm	-20,517	-27,572	-44,472	-54,971	-54,440	-53,829	Domestic financing
Në %	94.5	92.8	90.6	101.8	101.4	102.0	In %
Financim i huaj	-1,190	-2,138	-4,593	991	744	1,032	Foreign financing
Në %	5.5	7.2	9.4	-1.8	-1.4	-2.0	In %
Totali	-21,707	-29,710	-49,065	-53,980	-53,697	-52,797	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2026
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
TË ARDHURAT DOGANORE 2026 (CUSTOMS REVENUE)							
Taksë doganore	614	1,348	2,230	3,107	4,019	4,974	Customs Duties
TVSH	10,123	21,493	35,349	49,537	64,156	79,121	V.A.T
Akcizë	5,208	10,027	14,945	20,403	26,264	33,550	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	63	234	357	600	732	923	Others (Mineral Rent)
TOTALI	16,008	33,102	52,880	73,647	95,170	118,568	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2026 (TAX REVENUE)							
TVSH	12,352	18,494	25,157	29,532	35,844	41,577	V.A.T
Tatim mbi fitimin	3,442	7,399	19,605	23,574	26,647	31,065	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,621	14,133	22,933	31,715	40,218	47,572	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	4,351	7,737	10,866	14,254	17,633	21,317	National taxes
TOTALI	27,767	47,763	78,562	99,075	120,341	141,531	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	43,775	80,865	131,442	172,722	215,511	260,100	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2026

*The Deficit and Its Financing for 2026**Të dhëna progresive (Progresive Data)**në milionë Lek (in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
TË ARDHURAT	69,989	130,390	205,745	275,917	341,002	410,877	REVENUE
SHPENZIMET	48,282	100,680	156,680	221,936	287,306	358,080	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	21,707	29,710	49,065	53,980	53,697	52,797	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-21,707	-29,710	-49,065	-53,980	-53,697	-52,797	FINANCING
Financimi i brendshëm	-20,517	-27,572	-44,472	-54,971	-54,440	-53,829	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	3	7	13	16	22	30	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	-13,428	-20,900	-35,760	-44,255	-29,280	-18,317	Domestic borrowing
Të tjera	-7,092	-6,679	-8,725	-10,733	-25,182	-35,542	Others
Financimi i jashtëm	-1,190	-2,138	-4,593	991	744	1,032	Foreign
a. Hua afatgjatë (e marrë)	517	1,406	2,026	2,678	3,930	5,906	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	72	16	122	51	34	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,813	-3,964	-6,983	-9,549	-13,625	-15,553	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore	0	349	349	7,740	10,388	10,645	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave**Source:** Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milionë Euro

In millions Euro

	2022	2023	2024	2025	T1-2025	T2-2025	T3-2025	T4-2025	T1-2026	
Llogaria korrente	-1,118.48	-364.08	-608.68	-178.62	-316.27	-289.92	681.81	-254.24	-228.29	Current Account.
Bilanci tregtar	-4,320.97	-4,633.52	-5,592.91	-5,956.66	-1,271.75	-1,482.48	-1,610.18	-1,592.25	-1,320.54	Trade Balance.
Eksporti i mallrave fob	1,880.46	1,742.43	1,678.80	1,563.90	399.61	425.73	333.51	405.04	440.15	Merchandise Exports. Fob
Importi i mallrave fob	6,201.43	6,375.96	7,271.71	7,520.56	1,671.36	1,908.21	1,943.70	1,997.29	1,760.68	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	2,398.20	3,351.11	3,875.55	4,470.11	693.94	892.18	1,917.35	966.64	757.33	Services Balance.
Shërbimet Kredi	4,798.25	6,564.98	7,409.82	8,476.44	1,492.33	1,859.62	3,163.94	1,960.56	1,616.99	Services Credit
Shërbimet Debi	2400.05	3,213.87	3534.27	4006.33	798.38	967.44	1,246.59	993.92	859.67	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-314.76	-278.45	-192.76	-50.68	-40.57	-41.89	21.26	10.52	17.32	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	596.79	771.30	958.77	1,058.79	228.88	259.13	285.18	285.60	268.92	Income Credit
Të ardhurat Debi	911.55	1,049.75	1,151.54	1,109.47	269.45	301.03	263.92	275.08	251.60	Income Debt
Bilanci i transfertave	1,119.06	1,196.78	1,301.44	1,358.61	302.10	342.28	353.39	360.85	317.60	Balance of Transfers
Transferta private	1,280.21	1,367.95	1,507.51	1,589.09	357.46	399.06	411.88	420.70	373.54	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	161.16	171.18	206.07	230.48	55.36	56.78	58.49	59.85	55.94	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	20.14	45.81	-156.44	-99.39	-35.04	-8.10	-17.78	-38.48	-23.66	Capital Account
Llogaria financiare	-820.99	-1,002.05	-892.46	-1,198.87	-928.13	-268.47	206.51	-208.78	-224.70	Financial Account
Investime direkte	-1,189.95	-1,255.64	-1,340.04	-1,332.20	-293.19	-305.60	-377.14	-356.27	-348.45	Direct Investment
Investime portofoli	573.11	326.51	404.94	246.17	-560.99	-95.95	234.65	668.46	-61.90	Portfolio Investment
Investime të tjera	-266.63	-176.45	-98.97	-198.19	-115.78	106.43	334.94	-523.78	171.72	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	207.55	253.03	136.37	209.40	-0.44	82.43	49.52	77.89	47.40	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	-69.80	936.81	263.71	1,130.26	576.38	52.88	507.04	-6.05	20.15	Overall Balance
Rezervat	-69.80	936.81	263.71	1,130.26	576.39	52.89	507.05	-6.06	20.15	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-62.48	-103.53	-141.59	-85.35	-41.84	-26.65	-14.06	-2.80	-13.93	Use of Fund Credit and Loans

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	2026 Prill April	2026 Maj May	2026 Qershor June	Millions of Lek End of Period
Mjete valutore neto	892,687	975,231	1,016,861	1,125,009	1,128,698	1,132,783	1,129,594	1,137,376	1,173,060	1,169,421	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	981,133	1,054,939	1,101,478	1,265,903	1,244,463	1,255,254	1,240,851	1,251,477	1,282,676	1,285,276	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	88,446	79,707	84,617	140,894	115,765	122,471	111,257	114,101	109,615	115,855	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	1,211,348	1,218,505	1,326,853	1,455,716	1,485,238	1,486,035	1,481,767	1,481,377	1,489,317	1,506,178	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	491,750	467,993	483,962	504,915	538,739	531,811	515,690	505,781	503,957	506,039	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë	719,598	750,511	842,892	950,801	946,499	954,224	966,077	975,596	985,360	1,000,139	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjerë	1,659,293	1,701,598	1,785,246	1,967,794	1,988,338	1,983,818	1,976,869	1,988,406	2,028,163	2,048,794	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	387,652	393,796	423,539	483,446	481,172	481,801	482,770	486,086	493,873	505,722	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	645,637	689,106	727,641	806,699	826,185	819,699	810,114	817,584	841,524	846,524	Transferable deposits
Depozita të tjera	626,005	618,696	634,066	677,649	680,981	682,319	683,985	684,736	692,766	696,547	Other deposits
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	248,219	294,121	330,099	355,060	355,835	356,993	361,592	362,118	369,598	377,310	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	7,250	8,065	11,289	9,442	9,585	9,477	9,699	9,440	9,491	9,677	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	382	338	464	687	687	689	725	710	712	750	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	10,186	14,936	19,479	22,495	22,634	22,669	22,693	22,723	23,327	24,588	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	230,401	270,783	298,866	322,435	322,928	324,157	328,475	329,244	336,068	342,295	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	7,925	13,331	20,320	28,668	28,616	28,632	28,608	28,489	28,504	31,038	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	291	614	1,167	1,415	1,405	1,403	1,395	1,395	1,400	1,528	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	7,634	12,717	19,153	27,253	27,211	27,229	27,213	27,094	27,104	29,509	Other resident sectors
Huatë	4,636	5,880	4,609	8,671	14,889	10,950	12,318	13,092	7,352	7,251	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	4,636	5,880	4,609	8,671	14,889	10,950	12,318	13,092	7,352	7,251	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare											Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë											Other resident sectors
Llogari të pagueshme	86	110	42	58	116	198	14	213	6	25	Accounts payable
Korporata të tjera financiare											Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	69	0	0	1	1	0	1	1	1	0	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	17	110	42	57	115	198	13	213	5	25	Other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	191,658	191,644	215,912	244,550	247,053	252,855	246,488	244,247	243,984	240,361	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-46,106	-73,037	-76,032	-75,466	-71,105	-66,176	-62,604	-68,426	-67,082	-75,202	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,607	-14,425	-16,043	-25,637	-22,717	-16,961	-19,200	-21,590	-17,733	-30,133	Other items net
Detyrime të tjera	63,859	63,808	67,937	69,158	71,568	76,717	74,816	74,223	77,924	65,272	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	76,467	78,234	83,980	94,795	94,285	93,678	94,016	95,812	95,657	95,405	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	4,826	1,478	3,529	1,560	1,806	2,333	4,672	3,778	2,503	952	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab -
10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	2026 Prill April	2026 Maj May	2026 Qershor June	Millions of Lek End of Period
Totali i kredisë	713,552.1	744,162.6	835,816.7	943,744.9	939,337.7	946,861.6	958,717.3	968,235.8	977,996.9	992,771.2	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	204.8	103.0	23.9	11.4	10.8	10.3	9.8	9.3	8.7	8.4	Credits to local Government
Në lekë	204.8	103.0	23.9	11.4	10.8	10.3	9.8	9.3	8.7	8.4	in Lek
Në valutë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	23,714.0	16,754.0	18,958.8	18,999.2	18,416.2	16,955.1	14,845.0	14,774.9	15,328.6	15,476.4	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	10,508.7	9,247.1	7,354.1	12,345.3	12,164.4	12,072.1	12,029.6	12,076.4	12,612.8	12,793.5	in Lek
Në valutë	13,205.4	7,507.0	11,604.7	6,654.0	6,251.7	4,883.0	2,815.4	2,698.5	2,715.8	2,682.9	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	411,853.0	421,985.1	469,926.0	516,591.2	511,578.6	518,177.3	526,274.9	530,515.4	532,132.4	539,847.2	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	173,607.4	196,936.3	216,945.6	230,171.7	227,553.5	227,712.7	233,126.6	238,113.8	237,274.4	240,738.3	in Lek
Në valutë	238,245.6	225,048.8	252,980.4	286,419.5	284,025.1	290,464.6	293,148.4	292,401.6	294,857.9	299,108.9	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	15,557.4	19,468.4	22,212.3	20,820.0	20,673.2	20,288.9	20,192.7	20,207.4	20,122.6	20,185.7	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	8,668.9	12,411.3	14,719.3	12,293.1	12,098.7	11,975.2	11,673.5	11,704.7	11,641.1	11,576.9	in Lek
Në valutë	6,888.4	7,057.0	7,493.0	8,526.8	8,574.5	8,313.7	8,519.2	8,502.8	8,481.5	8,608.8	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	262,222.9	285,852.1	324,695.7	387,323.2	388,659.0	391,430.0	397,394.9	402,728.8	410,404.6	417,253.6	Credits to other resident sectors
Në lekë	175,900.8	204,247.3	245,076.4	300,731.8	303,253.1	306,239.7	311,666.6	317,021.5	324,707.4	332,391.7	in Lek
Në valutë	86,322.1	81,604.8	79,619.3	86,591.4	85,405.9	85,190.3	85,728.3	85,707.3	85,697.3	84,861.9	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11	OFERTA E PARASË											
	Money Supply											
	Mujor-Monthly											
	Në milionë Lekë	2022	2023	2024	2025	2026 Janar	2026 Shkurt	2026 Mars	2026 Prill	2026 Maj	2026 Qershor	Millions of Lek
	Fundi i periudhës					January	February	March	April	May	June	End of Period
Baza monetare	619,187	632,446	613,646	676,586	682,616	676,185	683,092	686,629	696,466	719,085		Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	387,652	393,796	423,539	483,446	481,172	481,801	482,770	486,086	493,873	505,722		Currency outside depository corporations
Agregati M1	735,839	772,430	845,659	967,787	988,414	982,561	976,365	989,421	1,002,711	1,027,056		M1 Aggregate
Agregati M2	939,309	976,037	1,052,791	1,194,179	1,218,503	1,214,801	1,209,884	1,223,734	1,245,453	1,271,407		M2 Aggregate
Burimi : Banka e Shqipërisë											Source : Bank of Albania	

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundit i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	2026 Prill April	2026 Maj May	2026 Qershor June	Millions of Lek End of Period
Totali i depozitave	1,271,642	1,307,802	1,361,707	1,484,349	1,507,167	1,502,018	1,494,099	1,502,320	1,534,290	1,543,072	Total deposits
Në lekë	551,657	582,241	629,252	710,733	737,331	733,000	727,114	737,648	751,580	765,684	In local currency
Depozitat e transferueshme	291,263	323,523	362,855	417,954	440,256	433,422	424,871	434,129	439,985	451,588	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,694	2,000	3,536	2,702	3,118	2,903	2,998	2,981	3,182	3,787	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	16,031	21,228	22,175	24,937	33,902	33,150	32,188	33,115	33,529	32,934	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,045	4,993	5,818	5,974	5,996	6,436	5,520	5,121	5,291	5,369	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	77,667	91,605	96,156	108,851	119,711	110,969	104,146	107,899	109,399	116,248	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	188,826	203,698	235,169	275,490	277,528	279,963	280,019	285,014	288,584	293,250	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	56,924	55,111	59,266	66,387	66,987	67,338	68,724	69,206	68,853	69,746	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,636	1,669	3,535	1,050	1,036	1,045	1,000	566	448	420	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	37	46	1	25	0	0	0	0	10	15	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,493	3,745	3,821	6,640	6,418	6,162	6,450	6,988	7,328	7,680	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	51,758	49,651	51,909	58,672	59,533	60,131	61,274	61,653	61,067	61,631	Other resident sectors
Depozita të tjera	203,470	203,607	207,131	226,391	230,089	232,240	233,519	234,313	242,742	244,351	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike			1,003	1,007	1,010	1,013	2,008	2,013	2,078	2,069	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	598	2,656	3,901	5,235	5,575	5,908	6,827	7,008	6,916	6,634	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,114	5,392	5,659	6,837	6,924	7,265	6,318	6,245	11,979	12,748	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,379	9,553	9,789	10,298	11,452	11,638	11,209	10,826	12,237	12,653	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,379	186,006	186,778	203,013	205,128	206,417	207,156	208,221	209,532	210,247	Other resident sectors
Në valutë	719,985	725,561	732,456	773,616	769,836	769,018	766,986	764,672	782,710	777,388	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	354,374	365,583	364,787	388,745	385,930	386,277	385,244	383,455	401,539	394,937	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	76	154	106	121	136	143	162	197	199	173	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	3,901	4,128	3,967	6,076	6,604	6,928	6,369	7,545	9,250	8,997	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,598	5,359	5,416	5,049	4,864	4,385	5,466	5,392	4,809	4,192	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	136,911	148,159	144,201	153,523	149,853	148,495	149,608	145,204	159,512	153,402	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	206,889	207,783	211,098	223,975	224,473	226,325	223,638	225,116	227,769	228,172	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	139,409	129,272	126,200	129,044	128,999	128,330	126,460	125,213	125,192	123,802	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike		2	1	1	1	1	1	1	1	1	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	101	6	6	6	6	6	6	6	6	6	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	0	0	5	5	13	12	4	9	8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	4,702	6,408	5,970	6,840	6,448	6,796	6,421	6,565	7,098	7,002	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	134,605	122,856	120,222	122,192	122,540	121,514	120,020	118,636	118,078	116,785	Other resident sectors
Depozita të tjera	226,202	230,706	241,469	255,827	254,907	254,411	255,282	256,004	255,979	258,649	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	984	219	2,572	2,635	2,637	2,872	2,808	2,797	2,799	2,753	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,607	2,923	2,374	2,045	2,052	2,072	2,458	2,173	2,403	2,626	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,561	8,183	10,107	8,113	7,588	7,457	7,663	7,871	8,655	9,062	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	23,903	22,444	19,474	18,062	17,507	17,127	16,896	17,887	16,752	19,127	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,147	196,937	206,942	224,972	225,122	224,883	225,458	225,276	225,370	225,081	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13	Tregues të shëndetit financiar (FSI)						Financial Soundness Indicators (FSI)	
	(në përqindje)						(in percentage)	
	Përshkrimi i treguesit	Janar'26	Shkurt'26	Mars'26	Prill'26	Maj'26	Qershor'26	Indicator's description
Tregues me bazë kapitalin								
Capital-based								
	Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	20.44	-	-	19.73	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
	Kapitali rregullator (mln lekë)	-	-	237,123.91	-	-	235,630.63	Regulatory capital (million lek)
	Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)	-	-	1,160,166.90	-	-	1,194,029.43	Risk-weighted assets
	Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	18.58	-	-	17.84	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
	Kapitali ndaj totalit të aktiveve							Capital as a percent of total assets
	Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.91	8.81	9.42	9.33	8.96	8.97	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
	Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.85	9.76	10.36	10.25	9.86	9.93	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
	Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.13	10.12	10.29	10.31	10.01	10.02	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
	Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)							Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
	Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	6.25	6.09	6.56	6.27	7.10	6.79	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
	Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.65	5.49	5.96	5.71	6.45	6.14	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
	Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.50	5.30	6.00	5.67	6.35	6.08	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
	Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	13.90	13.23	11.83	12.17	12.46	12.13	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
	Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)							Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
	Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.74	6.85	7.31	5.13	4.68	5.22	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
	Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.19	6.18	6.64	4.66	4.25	4.72	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
	Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.05	5.96	6.68	4.64	4.18	4.67	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet								
Asset-based indicators								
	Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	31.27	31.10	30.65	30.23	29.93	29.38	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
	Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	30.72	30.69	30.41	29.99	29.84	29.31	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
	Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	44.80	44.57	44.06	43.76	43.32	42.41	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
	Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	44.02	43.99	43.72	43.42	43.19	42.32	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
	Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.67	1.57	1.43	1.47	1.50	1.48	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
	Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	3.85	3.80	3.85	3.75	3.77	3.70	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve								
Income and expense-based								
	Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	76.51	75.88	77.33	76.19	74.95	73.77	Interest margin to gross income
	Shpenzime jointerеси ndaj të ardhurave bruto	55.66	57.52	59.13	58.48	59.00	59.12	Noninterest expenses to gross income
Të tjera								
Other								
	Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	11.00	12.00	13.00	Number of banks
Burimi: Banka e Shqipërisë								Source: Bank of Albania